



Titulli i projektit

Riorganizimi dhe Zgjerimi i rrjetit të Ujësjellësit dhe i Kanalizimeve (Bashkia Mat)

Tipi i projektit

Shërbimet Publike

Vendndodhja e projektit

Burrel, Komsi, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan

Buxheti i paravlerësuar

900,000 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në situatën e re të dalë nga shkrimja dhe bashkimi i njëjësive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Shërbimi i Ujësjellësit në Bashkinë Burrel ofrohet për 100% të popullsisë, ndërsa për ujrat e zeza së paku për 60% të saj. Në komunat e tjera aksesit i banorëve në skemat e furnizimit me këto shërbime është dhe më i ulët. Në qytetin e Burrelit shërbimi është i organizuar si shoqëri aksionere, kurse në pjesën e mbetur të territorit të dyja shërbimet janë të manaxhuara nga vetë komunat. Mbledhja e tarifave është nën nivelin e 50%. Krijimi i një entiteti të ri të zgjeruar, si Bashkia Mat, bën të nevojshëm riorganizimin e shërbimeve dhe shtimin e investimeve për të rritur shkallën e shërbimit dhe nivelin e aksesit në këto dy shërbime bazë, duke e bërë të krahasueshëm me nivelet kombëtare.

Qëllimi/et specifik të projektit

Riorganizimi i shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve dhe shtimi i investimeve për të rritur aksesin e banorëve në këtë shërbim në nivele të krahasueshme (jo më pak se) me normat mesatare kombëtare.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Riorganizimi i shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, për të përfshirë të gjitha njësitë e bashkuara në një entitet të vetëm të shërbimit për të gjithë banorët (një entitet shërbimi i organizuar si korporatë publike; totali i popullsisë për t'u shërbyer është më i madh se 27000 banorë; përqindja e aksesit në rrjetin e ujësjellësive më tepër se 85% dhe për ujërat e zeza më tepër se 50%);
- Vendosja e tarifave unike të shërbimit për furnizimin me ujë dhe kanalet e ujërave të zeza në gjithë territorin e Bashkisë së re Mat (tarifa e publikuar dhe përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Mat ose brënda taksës së gjelbërimit).
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostos së shërbimit të integruar për furnizimin me ujë dhe rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza (kosto për banor, si rrjedhojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbim).
- Rritja e nivelit të arkëtimit nga njëësia e shërbimit (bilanci i veprimtarisë së njësisë së shërbimit nuk është negativ).
- Investimet të reja për të përmirësuar aksesin e banorëve në këto shërbime të realizuara nga Bashkia Mat (plane dhe zbatimi i projekteve të investimit nga Bashkia Mat).
- Investime për rritjen e efektivitetit të shërbimit dhe faturimit të shërbimit dhe për të pakësuar humbjet (investimet në aparate matëse, kalimi nga tarifimi mbi shumë fikse në tarifë për m3).



Aktivitetet e projektit

- Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujësjellësit dhe ujërave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit (shoqëri aksionere apo bashkia).
- Rishikimi i planeve dhe projekteve të ish-njësive për investime dhe krijimi i një plani të integruar të këtyre investimeve në koordinim me strukturën përgjegjëse në nivel qendror.
- Harmonizimi i rregullores dhe statutit të njësisë që ofron shërbimin me ligjin mbi decentralizimin dhe financat lokale.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak i plan-projekteve të investimeve dhe kërkesave për financim nga donatorë, ose FSHZH, apo Fondi Rajonal i Zhvillimit.
- Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.
- Zhvillimi i materialeve promociionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit (fletëpalosje).

Maturimi i projektit

Aktualisht, shërbimi i furnizimit me ujë në njësitë që do të bashkohen për formimin Bashkisë Mat, ofrohet nga komunat. Kjo formë shërbimi është në ndryshim nga Bashkia ekzistuese e Burrelit, ku shërbimi ofrohet nga një shoqëri aksionere. Studimi pritet të japë rekomandime për mënyrën e ofrimit të shërbimit në të ardhmen.

Ekzistojnë shume plane investimesh në zonë, të realizuara nga ish-komunat apo Bashkia Burrel. Por këto plane duhet të ripunohen për t'iu përshtatur realitetit të ri të funksionimit të Bashkisë Mat.

Ligji i ri për funksionimin e Pushtetit Vendor pritet të specifikojë kompetencat dhe mënyrën e organizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nga njësitë e qeverisjes vendore.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Transferata e Pakushtëzuara
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët
- Fondi i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qendrore dhe Këshilli i Qarkut
- Donatorë: BE, BERZH, Kwf

Kostot e projektit

Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujësjellësit dhe ujërave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit 800,000

Zhvillimi i materialeve promociionale (2000 copë) 100,000